

ANKESE

Për: **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**

Nr1 i prokurimit	616-26-2559-2-1-1
-------------------------	--------------------------

Sa i përket tenderit për: **Mirmbajtja e sistemit të ujitjes dhe ujitja e sipërfaqeve gjelbëruese**

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Komplast 1985 SHPK

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Hilmi Ferizi, pn

(Adresa)

Ferizaj

(Vendi)

70000

(Kodi postar)

044/481686

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Gëzim Ibrahimi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

Komdrill@hotmail.com

(Adresa elektronike)

21.08.2026

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË. Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- Njoftimi për kontratë: **27.04.2026**
- B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara **28.04.2026**
- B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara **18.05.2026**
- B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara **19.05.2026**
- B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara **01.06.2026**
- Procesverbali i hapjes: **12.08.2025**
- Njoftimi mbi vendimin e AK-së: **18.08.2026**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

Procesverbali i hapjes është pranuar përmes platformës së e-prokurimit

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet e Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 nga ana e AK-së:

Neni 1 Qëllimi

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 52 Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës

Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës.

Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimi

Neni 65 Provueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve

Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Gjithashtu AK ka shkelur edhe dispozitat përkatëse të RrUOPP-se.

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

ANKESE

ANKESË DREJTUAR ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT

Lënda: Ankesë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja e sistemit të ujitjes dhe ujitja e sipërfaqeve gjelbëruese”, me nr. të prokurimit [616-26-2559-2-1-1](#)

Grupi i Operatorëve Ekonomikë, i përbërë nga Komplast 1985 Sh.p.k., në cilësinë e liderit të konzorciumit, dhe Zahiri Sh.p.k., ka marrë pjesë në aktivitetin e prokurimit me titull “Mirëmbajtja e sistemit të ujitjes dhe ujitja e sipërfaqeve gjelbëruese”, me nr. të prokurimit [616-26-2559-2-1-1](#), të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës. Pas përfundimit të procesit të vlerësimit, grupi ynë është renditur si ofertuesi i dytë, ndërsa si grup i operatorëve ekonomikë të propozuar për kontratë është shpallur Kom Group Sh.p.k. & Kushtrimi NM Sh.p.k. Pas ushtrimit të së drejtës sonë për qasje në dokumentacionin e operatorit ekonomik të propozuar për kontratë, kemi konstatuar një numër të madh parregullsish, mangësish dhe

mospërputhjesh në dokumentacionin e tyre ofertues, pasi sipas vlerësimit dhe analizës sonë, shumë nga dokumentet dhe dëshmitë e paraqitura nga ky grup nuk i përmbushnin kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në kërkesat e Autoritetit Kontraktues. Për këtë arsye, duke ushtruar të drejtën tonë ligjore, kemi paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, duke ngritur pretendime konkrete dhe duke kërkuar që dokumentacioni i operatorit të propozuar për kontratë të shqyrtohet në mënyrë të drejtë, objektive dhe në përputhje me kërkesat e procedurës së prokurimit.

Megjithatë, në vend që pretendimet tona të shqyrtoheshin në thelb dhe Autoriteti Kontraktues Komuna e Prishtinës të jepte përgjigje konkrete për secilën nga shkeljet e ngritura, gjatë kësaj procedure kanë ndodhur rrethana jashtëzakonisht serioze, të cilat sipas nesh kërkojnë vëmendjen dhe shqyrtimin e menjëhershëm të Organi Shqyrtues të Prokurimit dhe institucioneve të tjera kompetente. Konkretisht, sipas rrethanave dhe provave që posedojmë, ndaj kompanisë Zahiri Sh.p.k., e cila ishte pjesë përbërëse e konzorciumit tonë, është ushtruar presion me qëllim që kjo kompani të tërhiqej gje kjo qe na ka konfirmuar vet pronari i Zahiri Shpk nga konzorciumi dhe të distancohej nga procedura e kundërshtimit të vendimit të Komunës së Prishtinës. Përfaqësuesit e kësaj kompanie janë vënë përballë presioneve dhe kërcënimeve se, nëse nuk tërhiqen nga konzorciumi dhe nga kundërshtimi i këtij aktiviteti të prokurimit, në të ardhmen nuk do të kenë mundësi të fitojnë punë apo kontrata nga Komuna e Prishtinës.

Si rezultat i këtij presioni, Zahiri Sh.p.k. është tërhequr nga konzorciumi. Ajo që e bën këtë situatë edhe më serioze është fakti se Autoriteti Kontraktues më pas ka përdorur pikërisht tërheqjen e Zahiri Sh.p.k. si arsye për të mos e trajtuar kërkesën tonë për rishqyrtim dhe për të mos u përgjigjur në thelb ndaj shkeljeve konkrete që kemi ngritur lidhur me dokumentacionin e operatorit ekonomik të propozuar për kontratë. Një veprim i tillë është i papranueshëm dhe ngre dyshime jashtëzakonisht serioze, pasi nuk mund të pranohet që një anëtar i një konzorciumi të vendoset nën presion për t'u tërhequr dhe më pas vetë rezultati i kësaj tërheqjeje të përdoret si mekanizëm për të eliminuar të drejtën e grupit të operatorëve ekonomikë për të kërkuar mbrojtje juridike dhe për të shmangur shqyrtimin e shkeljeve të ngritura në procedurën e prokurimit.

Keto rrethanat përbëjnë dyshime serioze për veprime që cenojnë integritetin e procedurës së prokurimit publik, ushtrimin e presionit ndaj operatorëve ekonomikë, pengimin e ushtrimit të të drejtave ligjore, ndikimin e paligjshëm në procedurat publike dhe keqpërdorimin e pozitës apo autoritetit zyrtar. Ne konsiderojmë se mënyra se si është zhvilluar kjo procedurë dhe mënyra se si është trajtuar kërkesa jonë për rishqyrtim nuk përputhet me parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe konkurrencës së drejtë. Akoma më shqetësues është fakti se, në vend që Autoriteti Kontraktues të përballej me pretendimet tona konkrete për mangësitë dhe parregullsitë në ofertën e operatorit të propozuar për kontratë, procedura është devijuar drejt krijimit të rrethanave që kanë rezultuar në tërheqjen e njërit prej anëtarëve të konzorciumit tonë.

Për këtë arsye, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që ta shqyrtojë këtë çështje me seriozitet maksimal, të analizojë në mënyrë të plotë dhe meritore të gjitha pretendimet që kemi ngritur lidhur me dokumentacionin dhe ofertën e grupit të operatorëve ekonomikë Kom Group Sh.p.k. & Kushtimi NM Sh.p.k të mos lejojë që tërheqja e Zahiri Sh.p.k. të përdoret si arsye për shmangien e shqyrtimit të shkeljeve të ngritura nga ana jonë dhe të vlerësojë ligjshmërinë e plotë të veprimeve dhe mosveprimeve të Autoritetit Kontraktues gjatë kësaj procedure. Çdo pretendim i ngritur nga ne duhet të shqyrtohet në substancë dhe Autoriteti Kontraktues duhet të japë përgjigje të argumentuar për secilën shkelje të pretenduar, e jo të shmangë përgjegjësinë përmes rrethanave procedurale të krijuara pas ushtrimit të kërkesës për rishqyrtim.

Theksojmë se Komplast 1985 Sh.p.k. nuk do të tërhiqet nga kërkimi i së drejtës dhe nuk do të pranojë që një proces i prokurimit publik të zhvillohet në rrethana ku operatorët ekonomikë mund të përballen me presion, kërcënime apo pasoja në marrëdhëniet e tyre të ardhshme kontraktuese vetëm për shkak se kanë vendosur të kundërshtojnë një vendim të Autoritetit Kontraktues dhe të ushtrojnë të drejtat e tyre ligjore. Ne posedojmë informacione dhe prova që, paraqesin bazë serioze për shqyrtimin e këtyre rrethanave nga institucionet kompetente dhe jemi të gatshëm që këto fakte dhe prova t'i paraqesim në procedurat përkatëse si dhe do të behet mediatike cilidoqoft vendimi i OSHP Komplast 1985 Shpk nuk do të ndalet.

Nëse kjo çështje nuk shqyrtohet në mënyrë të drejtë, objektive dhe të paanshme dhe nëse nuk ndërmerren masat e nevojshme për të garantuar ligjshmërinë dhe integritetin e kësaj procedure, ne do të vazhdojmë ndjekjen e kësaj çështjeje përmes të gjitha mjeteve juridike në dispozicion. Prrovat dhe faktet rezultojnë ekzistenca e elemente të veprave penale, çështja do t'u paraqitet institucioneve kompetente për hetimin e dyshimeve për korrupsion, shantazh, ushtrim të ndikimit të paligjshëm dhe keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar. Po ashtu, jemi të vendosur që këtë çështje ta ndjekim edhe përmes procedurave gjyqësore kompetente, duke paraqitur të gjitha provat që posedojmë dhe duke kërkuar përgjegjësi për çdo veprim të kundërligjshëm që mund të jetë kryer gjatë kësaj procedure.

Një çështje e veçantë që nuk mund të anashkalohet në këtë procedurë është tërheqja e Zahiri Sh.p.k. nga konzorciumi. Sipas fakteve dhe provave që posedojmë, kjo tërheqje ka ndodhur jo për shkak të ndonjë mosmarrëveshjeje të zakonshme ndërmjet partnerëve të konzorciumit apo për shkak të mungesës së interesit për vazhdimin e këtij aktiviteti, por në rrethana që, sipas nesh, tregojnë se Zahiri Sh.p.k. ka zgjedhur të tërhiqet nga mbrojtja e interesit të përbashkët të konzorciumit me qëllim të ruajtjes ose përfitimit të marrëdhënieve dhe interesave të saj të ardhshme me Autoritetin Kontraktues. Për këtë çështje disponojmë fakte dhe prova konkrete, të cilat do t'i përdorim në procedurat përkatëse ligjore.

Për këtë arsye, Komplast 1985 Sh.p.k. është duke përgatitur ndjekjen e rastit përmes rrugës gjyqësore, për të kërkuar shqyrtimin e plotë të rrethanave që kanë çuar në tërheqjen e Zahiri Sh.p.k. nga konzorciumi dhe dëmin që kjo tërheqje i ka shkaktuar Komplast 1985 Sh.p.k. dhe interesave të saj në këtë procedurë. Dhe do të kërkojmë përgjegjësi të plotë për dëmin dhe pasojat që na janë shkaktuar.

Megjithatë, kërkojmë nga OSHP-ja që të mos lejojë që kjo çështje të mbetet pa zgjidhje për shkak të tërheqjes së Zahiri Sh.p.k. dhe të mos pranojë që një tërheqje e tillë të shërbejë si mjet për mbylljen e pretendimeve tona pa u shqyrtuar ato në substancë. OSHP-ja duhet ta vlerësojë këtë rast mbi bazën e fakteve, dokumentacionit dhe shkeljeve të ngritura në procedurën e prokurimit. Një vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj nga OSHP-ja mund ta zgjidhë këtë çështje brenda mekanizmave institucionalë dhe të shmangë nevojën që rasti të vazhdojë në procedura të mëtejshme gjyqësore. Në të kundërtën, Komplast 1985 Sh.p.k. do të ndjekë të gjitha rrugët juridike për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të saj, duke paraqitur para institucioneve kompetente të gjitha faktet dhe provat që posedon lidhur me këtë rast.

Prandaj, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që të mos e trajtojë këtë rast si një kontest të zakonshëm ndërmjet operatorëve ekonomikë, por të marrë parasysht të gjitha rrethanat e krijuara gjatë këtij procesi dhe të sigurojë një shqyrtim të plotë, të pavarur dhe të paanshëm të procedurës. Ne kërkojmë që të analizohen të gjitha shkeljet e ngritura kundër operatorit ekonomik të propozuar për kontratë, të vlerësohet ligjshmëria e vendimit të Autoritetit Kontraktues për mosshqyrtimin e kërkesës sonë dhe të ndërmerren të gjitha masat që janë në kompetencën e OSHP-së për të mbrojtur ligjshmërinë, konkurrencën e drejtë dhe integritetin e prokurimit publik. Kjo çështje nuk ka të bëjë vetëm me interesin tonë ekonomik, por me

mbrojtjen e së drejtës së çdo operatori ekonomik që të marrë pjesë në procedurat e prokurimit publik dhe të ushtrojë mjetet juridike të garantuara me ligj pa u përballur me presion, frikësim apo pasoja të padrejta.

OSHP duhet të shqyrtojë kete ankese si dhe të trajtohem si të barabart pasi terheqja e Zahiri Shpk ishte ne momentin e fundit ku autoriteti e detyroi ne ditën e fundit të dergojë email që të terhiqet dhe ta përdor atë që mos na pranoj kërkesën për rishqyrtim. Kërkojmë nga ju që të trajtohem nisoj edhe pa antarin e konzorciumit tashme dhe ne si lider i qendrojmë mbrapa se punët e kërkuara në kete projekt nga autoriteti do të kryhen ashtu siq duhet dhe në kohën e duhur

Në përfundim, shpresojmë që Organi Shqyrtues i Prokurimit ta shqyrtojë këtë rast me seriozitet dhe paanshmëri, të zbardhë plotësisht të gjitha rrethanat dhe të vlerësojë në mënyrë meritore secilën nga parregullsitë e paraqitura nga ana jonë. Duke u bazuar në faktet, provat dhe shkeljet e evidentuara, kërkojmë anulimin e vendimit të Autoritetit Kontraktues për shpalljen fitues të Grupit të Operatorëve Ekonomikë Kom Group Sh.p.k. & Kushtrimi NM Sh.p.k., pasi konsiderojmë se oferta dhe dokumentacioni i tyre nuk përmbushin kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Njëkohësisht, kërkojmë që lënda të kthehet në rivlerësim, ku ofertat të shqyrtohen në mënyrë të plotë, objektive dhe në përputhje të rreptë me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe dispozitat ligjore në fuqi. Nëse gjatë një rivlerësimi të drejtë dhe të bazuar në dokumentacionin e paraqitur konstatohet se oferta jonë është e përgjegjshme dhe përmbush të gjitha kërkesat e tenderit, kërkojmë që Grupi ynë i Operatorëve Ekonomikë të shpallet fitues i kësaj procedure.

Më poshtë gjeni të paraqitura në mënyrë të detajuar të gjitha parregullsitë, mangësitë dhe shkeljet e konstatuara në dokumentacionin dhe ofertën e Grupit të Operatorëve Ekonomikë të propozuar për kontratë, përkatësisht Kom Group Sh.p.k. & Kushtrimi NM Sh.p.k., të cilat janë ngritur nga ana jonë, por që Autoriteti Kontraktues i ka injoruar, nuk i ka trajtuar në mënyrë meritore dhe nuk ka dhënë përgjigje konkrete dhe të argumentuar lidhur me secilën prej tyre të cilat i kemi paraqitur tek kërkesa për rishqyrtim.

KERKESA PER RISHQYRTIM

Për shkak se AK- **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**

Ne mënyrë të kundërligjshme ka shpallur fitues: **Grup i Operatorëve Ekonomik Kom Group SH.P.K.; KUSHTRIMI NM SH.P.K.; Company Murseli SH.P.K,** operator i cili është dashur të eliminohet nga **procedura duke i analizuar shkeljet dhe mospermbushjen e** kërkesave të Autoritetit Kontraktues (AK-se) të vendosura në Njoftim për kontratë (NJK) dhe në Dosje të Tenderit (DT.)

Sqarojmë në mënyrë të detajuar shkeljet si në vijim:

- **Shkelja 1** - Në kuadër të Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomikë 6.4 Kërkesat e përshtatshmërisë:- Dëshmia e kërkuar dokumentare : **3. Një vërtetim nga Gjykata që vërteton se a.Operatori ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluar nuk a është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një veprë penale;**

Nga qasja në dokumentet e ofertës, rezulton se nuk janë dorëzuar dëshmitë përkatëse gjyqësore për drejtuesit e kompanive: Kushtrimi NM SH.P.K. Company Murseli SH.P.K. Pra, nuk rezulton të jetë

paraqitur dokumentacioni i kërkuar që dëshmon përmbushjen e kësaj kërkesë edhe për drejtuesit, menaxherët apo drejtorët përkatës të këtyre operatorëve ekonomikë. Kjo përbën mungesë të një dëshmie të kërkuar shprehimisht në Dosjen e Tenderit, pasi kërkesa nuk është kufizuar vetëm në operatorin ekonomik si subjekt juridik, por në mënyrë të qartë ka përfshirë edhe drejtuesit, menaxherët dhe drejtorët e tij. Për rrjedhojë, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të verifikojë dokumentacionin e dorëzuar në ofertat përkatëse dhe të konstatojë nëse janë përmbushur kërkesat e përcaktuara në pikën 6.4 të Dosjes së Tenderit. Nëse vërtetimet përkatëse për drejtuesit e Kushtrimi NM SH.P.K. dhe Company Murseli SH.P.K. nuk janë dorëzuar, atëherë ofertat përkatëse nuk kanë dëshmuar përmbushjen e një kërkesë të detyrueshme të pranueshmërisë dhe duhet të trajtohen në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.

- **Shkelja 2** - Në kuadër të Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomikë 6.4 Kërkesat e përshtatshmërisë:- Dëshmia e kërkuar dokumentare : **3. Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit. Kërkohet kopja vetëm nga Operatori Ekonomik që propozohet për shpërbllim të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues.**

Nga qasja në dokumentet e operatorit ekonomik Company Murseli SH.P.K., rezulton se është dorëzuar një Vërtetim Tatimor, nga i cili rezulton se kompania është në marrëveshje për shlyerjen e obligimeve/borxheve tatimore. Megjithatë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nuk rezulton e qartë se kur është lidhur kjo marrëveshje për shlyerjen e borxhit, çka është një element thelbësor për të vlerësuar nëse operatori ekonomik ka qenë në përmbushje të kërkesës së përcaktuar në Dosjen e Tenderit në momentin përkatës. Në këtë rast, vetëm fakti se operatori ekonomik ka një marrëveshje për shlyerjen e borxhit nuk e sqaron në mënyrë të mjaftueshme kohën e lidhjes së marrëveshjes, statusin e obligimeve dhe nëse në momentin e dorëzimit të dëshmisë tatimore operatori ekonomik i ka përmbushur kushtet e përcaktuara në Dosjen e Tenderit. Andaj, Autoriteti Kontraktues është dashur të verifikojë në mënyrë të plotë dhe të qartë datën e lidhjes së marrëveshjes për shlyerjen e borxhit, si dhe statusin e obligimeve tatimore të Company Murseli SH.P.K., në mënyrë që të konstatohet nëse dëshmia e paraqitur përmbush kërkesën e përcaktuar në pikën 6.4 të Dosjes së Tenderit. Në mungesë të një dokumenti ose të dhëne të qartë që dëshmon kur është lidhur marrëveshja për shlyerjen e borxhit dhe nëse operatori ekonomik i ka përmbushur kushtet tatimore të kërkuara, pranimi i kësaj dëshmie pa verifikim të mëtijshëm është i kontestueshëm. Për këtë arsye, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të verifikojë datën e lidhjes së marrëveshjes për shlyerjen e borxhit dhe statusin tatimor të operatorit ekonomik, dhe të konstatojë nëse Company Murseli SH.P.K. ka përmbushur në tërësi kërkesën e përcaktuar në pikën 6.4 të Dosjes së Tenderit.

- **Shkelja 3** - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.21. **Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme në vlerë minimale prej 375,000Euro, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë). Dëshmia e kërkuar dokumentare 1. Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 9 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës të bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve.**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik Kom Group, rezulton se kjo kompani është themeluar më 21.02.2025, fakt ky që dëshmohet edhe nga Certifikata e Biznesit së operatorit ekonomik. Megjithatë, në Aneksin 9, të plotësuar, nënshkruar dhe vulosur nga Kom Group, janë paraqitur kontrata të cilat, sipas të dhënave të evidentuara në dokumentacion, nuk janë kontrata të lidhura nga Kom Group, ndërsa disa prej tyre janë kontrata të lidhura para datës së themelimit të kompanisë, pra para datës 21.02.2025. Kjo paraqet një mospërputhje të qartë dhe thelbësore ndërmjet dokumenteve të ofertës dhe të dhënave zyrtare për themelimin e operatorit ekonomik. Një kompani e themeluar më 21.02.2025 nuk mund të pretendojë si përvojë të saj kontrata të realizuara ose të lidhura para ekzistimit juridik të saj, përveç rasteve kur ekziston bazë e qartë juridike dhe dokumentare që dëshmon se përvoja është transferuar ose se është përfituar në mënyrë të ligjshme nga një subjekt tjetër, gjë e cila duhet të dëshmohet në mënyrë konkrete. Në rastin konkret, nga dokumentet e qasshme nuk rezulton se Kom Group ka qenë palë kontraktuese në kontratat e paraqitura në Aneksin 9, ndërsa datat e disa prej kontratave janë paraprake ndaj datës së themelimit të operatorit ekonomik. Për më tepër, duke marrë parasysh se kërkesa e Dosjes së Tenderit kërkon përvojë në kontrata të ngjashme në vlerë minimale prej 375,000.00 Euro, në 3 vitet e fundit, nëse nga lista e Aneksit 9 largohen kontratat të cilat nuk i përkasin Kom Group ose janë lidhur para themelimit të saj, atëherë operatori ekonomik nuk dëshmon përmbushjen e kërkesës minimale për përvojë profesionale.

Andaj, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të bëjë një verifikim të plotë të kontratave të paraqitura në Aneksin 9, duke përfshirë palën kontraktuese, datën e lidhjes së kontratës, datën e realizimit, përfituesin dhe dokumentet mbështetëse.

Për rrjedhojë, operatori ekonomik Kom Group është dashur të konsiderohet i papërshtatshëm dhe të eliminohet nga procedura, për shkak të mosplotësimit të kërkesës së përcaktuar në pikat 9.1 dhe 9.2 të Dosjes së Tenderit.

- **Shkelja 4** - Anëtari i Koncerciumit Kushtrimi NM SH.P.K., ka paraqitur një listën mirëpo Lista nuk është sipas kërkesës së dosjes së tenderit, më saktësisht Aneksi 9-

Anëtari i konsorciumit KUSHTRIMI NM SH.P.K. ka paraqitur një listë të kontratave, mirëpo kjo listë nuk është paraqitur në formatin dhe sipas kërkesave të përcaktuara në Aneksin 9 të Dosjes së Tenderit, si dhe nuk përmban të dhënat sipas kërkesës së dosjes së tenderit. Për më tepër, edhe nga përmbajtja e kontratave dhe referencave të paraqitura, rezulton se KUSHTRIMI NM SH.P.K. nuk e përmbush vlerën minimale prej 375,000.00 Euro të kontratave të ngjashme, të kërkuar për periudhën përkatëse. Nga dokumentacioni i paraqitur rezultojnë këto kontrata:

Kontrata	Vlera
Ndërtimi i rrjeteve të Ujësjiellësit – Kontrata e rregullt	166,316.77 €
Ndërtimi i rrjeteve të Ujësjiellësit – Aneks Kontrata	7,307.50 €
Ndërtimi i rrjetit të ri të ujësjiellësit dhe kalimi i kycjeve individuale të konsumatorëve nga gypat AC në HDPE	103,105.00 €

Ndërrimi i rrjetit të ujësjellësit në disa rrugë të qytetit të Ferizajt

89,484.20 €

Gjithsej

366,213.47 €

Siç rezulton qartë nga përlogaritja, vlera totale e kontratave të paraqitura është vetëm 366,213.47 Euro, pra 8,786.53 Euro më pak se vlera minimale prej 375,000.00 Euro e përcaktuar në Dosjen e Tenderit. Për rrjedhojë, edhe nëse të gjitha këto kontrata do të konsideroheshin si kontrata të ngjashme dhe do të pranoheshin si të vlefshme, KUSHTRIMI NM SH.P.K. përsëri nuk arrin pragun minimal prej 375,000.00 Euro të kërkuar nga Autoriteti Kontraktues.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga dy anëtarët e tjerë të konsorciumit, nuk rezulton se këta operatorë ekonomikë kanë paraqitur kontrata të ngjashme që përmbushin kërkesën e përcaktuar në Dosjen e Tenderit.

Pra, në rastin konkret: KUSHTRIMI NM SH.P.K. ka paraqitur kontrata me vlerë totale vetëm 366,213.47 Euro, nën pragun minimal prej 375,000.00 Euro;

- **Shkelja 5** - Lista e paraqitur nga KUSHTRIMI NM SH.P.K. nuk është në përputhje me formatin dhe kërkesat e Aneksit 9; Dy anëtarët e tjerë të konsorciumit nuk kanë paraqitur kontrata të ngjashme që dëshmojnë përmbushjen e kërkesës së përcaktuar në Dosjen e Tenderit. Andaj, konsorciumi në tërësi nuk ka dëshmuar përmbushjen e kërkesës minimale për përvojë profesionale, as në aspektin e vlerës së kërkuar dhe as përmes dokumentacionit të kërkuar sipas Aneksit 9

- **Shkelja 6** - **Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 c) Inxhinieri diplomuar ose Bachelor i diplomuar I gjeologjisë me tri vite përvojë pune pas diplomimit. Për pikat c), - Të dëshmohet me CV-në e nënshkruar, diploma mbi kualifikimin, referenca per punët e mëparshme dhe kontrata e punes me punedhënesin ose marrveshje per këtë projekt.**

Në cilësinë e Inxhinierit të Gjeologjisë, ka ofertuar z. Bekim Toni, për të cilin në ofertë është dorëzuar një CV ku është përshkruar përvoja e tij profesionale. Megjithatë, referenca e paraqitur në ofertë për të dëshmuar përvojën profesionale të këtij inxhinieri nuk përputhet me të dhënat e paraqitura në CV.

Konkretisht, në CV-në e dorëzuar nuk është evidentuar fare angazhimi i z. Bekim Toni në kompaninë Company Murseli SHPK, ndërsa pikërisht nga kjo kompani është lëshuar referenca e paraqitur nga operatori ekonomik si dëshmi e përvojës së tij profesionale. Kjo paraqet një mospërputhje të drejtpërdrejtë dhe thelbësore ndërmjet dokumenteve të ofertës, pasi përvoja e pretenduar në referencë nuk është e pasqyruar në CV-në e kandidatit. Për më tepër, në mungesë të paraqitjes së këtij angazhimi në CV, ekzistojnë dyshime serioze lidhur me autenticitetin e references. Për këtë arsye, referenca e paraqitur nuk mund të konsiderohet si dëshmi i rregullt dhe e besueshme e përvojës profesionale.

Andaj, edhe në këtë rast, operatori ekonomik është dashur të eliminohet nga procedura, përkatësisht të mos i merret për bazë kjo referencë për përmbushjen e kërkesës profesionale, pasi dokumentet e paraqitura nuk janë në përputhje me njëra-tjetrën.

SHKELJA 6.1 Në dosjen e tenderit është kërkuar që operatori ekonomik të ketë në dispozicion një inxhinier të ndërtimtarisë ose person me diplomë Bachelor dhe së paku 3 vite përvojë pune. Për plotësimin e këtij kriteri, operatori ekonomik i shpallur fitues ka propozuar inxhinierin Deme Loshaj dhe ka dorëzuar si dëshmi një referencë të lëshuar nga Fidani L., me datë 20.01.2023. Në këtë referencë është cekur se inxhinieri Deme Loshaj ka filluar punën më datë 16.03.2021. Megjithatë, nga kjo dëshmi rezulton se deri në datën e lëshimit të referencës, pra më 20.01.2023, inxhinieri Deme Loshaj kishte rreth 1 vit e 10 muaj përvojë pune, dhe jo 3 vite. Për këtë arsye, vetëm kjo referencë nuk mund të dëshmojë përmbushjen e kërkesës për së paku 3 vite përvojë pune, pasi periudha nga 16.03.2021 deri më

20.01.2023 nuk i arrin 3 vite. Nëse operatori ekonomik ka pretenduar se inxhinieri i propozuar i ka plotësuar 3 vitet e përvojës së kërkuar, atëherë është dashur të paraqesë dokumentacion shtesë dhe të qartë që dëshmon vazhdimësinë e marrëdhënies së punës dhe përvojën e fituar pas datës 20.01.2023, deri në periudhën relevante për përmbushjen e kriterit. Pranimi i kësaj reference si dëshmi e mjaftueshme për 3 vite përvojë, pa u mbështetur në dokumente të tjera që dëshmojnë periudhën e plotë të përvojës, përbën vlerësim të gabuar të dokumentacionit të ofertuesit dhe moszbatim të kërkesave të përcaktuara në dosjen e tenderit. Autoriteti Kontraktues ka qenë i obliguar që të verifikojë në mënyrë të plotë dhe objektive nëse operatori ekonomik i shpallur fitues i ka përmbushur të gjitha kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe, në veçanti, kërkesën për 3 vite përvojë pune të inxhinierit të propozuar. Nuk është e mjaftueshme që të merret për bazë vetëm fakti se në referencë është shënuar data e fillimit të punës, pa u dëshmuar me dokumentacion të vlefshëm edhe periudha e plotë prej 3 vitesh. Për më tepër, nëse referenca e datës 20.01.2023 është dokumenti kryesor mbi të cilin Autoriteti Kontraktues është bazuar për ta konsideruar këtë kriter të përmbushur, atëherë kjo dëshmi në mënyrë të qartë nuk e mbulon periudhën minimale të kërkuar prej 3 vitesh. Në këto rrethana, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje gjatë vlerësimit të ofertës dhe ka pranuar si të plotësuar një kriter i cili, bazuar në dokumentacionin e paraqitur, nuk është dëshmuar në mënyrën e kërkuar nga dosja e tenderit. Një veprim i tillë cenon edhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë, pasi të gjithë ofertuesit duhet t'u nënshtrohen të njëjtave kërkesa dhe të njëjtit standard gjatë vlerësimit kërkojmë që oferta e operatorit ekonomik të shpallur fitues të trajtohet në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, si dhe të ndërmerren veprimet përkatëse lidhur me vendimin e dhënë.

- **Shkelja 7 - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2**

d) Një inxhinier i diplomuar i elektroteknikës ose Master i diplomuar, me 3 vite përvojë pune pas diplomimit Për pikat d) - Të dëshmohet me CV-në e nënshkruar, diploma mbi kualifikimin, referenca për punët e mëparshme dhe kontrata e punës me punedhënesin ose marrveshje për këtë projekt.

Në cilësinë e Inxhinierit të Elektroteknikës, operatori ekonomik ka ofertuar z. Avni Hajdini, për të cilin gjithashtu është dorëzuar një CV ku është përshkruar përvoja e tij profesionale. Edhe në këtë rast, referenca e paraqitur pas kërkesës për informata shtesë nga ana e AK ndaj nga operatori ekonomik nuk përputhet me të dhënat e deklaruara në CV. Konkretisht, në CV-në e z. Avni Hajdini nuk është paraqitur angazhimi i tij i mëhershëm në kompaninë e cila pretendohet se ka lëshuar referencën e paraqitur në ofertë. Rrjedhimisht, ekziston një mospërputhje e qartë ndërmjet CV-së dhe referencës, pasi një përvojë profesionale që pretendohet se është realizuar në kompaninë lëshuese të referencës nuk është deklaruar fare në CV-në e kandidatit. Kjo mospërputhje është veçanërisht e rëndësishme, pasi referenca është përdorur për të dëshmuar përvojën profesionale të kandidatit, ndërsa vetë dokumenti bazë i kandidatit – CV-ja – nuk e përmban këtë përvojë. Për këtë arsye, referenca e paraqitur nuk mund të merret si dëshmi e besueshme.

Andaj, edhe në këtë rast, operatori ekonomik është dashur të eliminohet nga procedura, përkatësisht të mos i merret për bazë kjo referencë për përmbushjen e kërkesës profesionale, pasi dokumentet e paraqitura nuk janë në përputhje me njëra-tjetrën.

- Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.22. Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit; Aneksin 7 te DT.
a) Nje kamion per bartjen e dheut,max 8 ton
b) Nje makine per saldim te gypave PVC PE
d) Traktor me luge ngarkuese me lopata rrafshuese
f) Nje eskavator me goma per ngarkimi te dheut deri ne 6 ton,me regjistrim valid
g) Nje kamion per bartjen e dheut 8m3

2. *Dëshmia e kërkuar dokumentare:* Një listë të mjeteve apo pajisjeve teknike që janë në dispozicionin tuaj për të ekzekutuar kontratën në fjalë- pajisjet dhe makineria në dispozicion duhet të dëshmohen me kopje të librezave mbi pronësinë e tyre ose DUD-i doganor. Në rast të marrjes me qera duhet të dëshmohet edhe me kontratë mbi qeramarrjen.

- **Shkelja 8 - Kamion për bartjen e dheut, max. 8 ton-** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Grupi i Operatorëve Ekonomikë, rezulton se kjo kërkesë nuk është përmbushur në pajtim me specifikacionin e përcaktuar në Dosjen e Tenderit.

Konkretisht, për këtë kërkesë është paraqitur kamionet, dhe jo kamioni sipas kërkesës së përcaktuar në specifikacionin teknik. Për më tepër, edhe nga të dhënat e mjeteve të deklaruara rezulton se mjetet e paraqitura nga anëtarët e grupit tejkalojnë kufirin maksimal prej 8 tonësh.

KUSHTRIMI NM SH.P.K.–kamioni 06-631-DQ–tejkalon kufirin maksimal të përcaktuar prej 8 tonësh
 Company Murseli SH.P.K.–kamioni 05-324-ED–tejkalon kufirin maksimal prej 8 tonësh;

Company Murseli SH.P.K. – kamioni 05-829-IM–gjithashtu tejkalon kufirin maksimal prej 8 tonësh.

Pra, kërkesa e Autoritetit Kontraktues ka qenë e qartë dhe specifike: kamion për bartjen e dheut me kapacitet maksimal 8 ton. Nuk është përcaktuar “minimum 8 ton”, por në mënyrë të qartë është përcaktuar “max. 8 ton”, që nënkupton se mjeti i ofruar nuk duhet ta tejkalojë këtë kufi.

Për rrjedhojë, mjetet e paraqitura nuk e përmbushin specifikacionin teknik të kërkuar.

Për këtë arsye, kërkesa teknike për “Kamion për bartjen e dheut, max. 8 ton” nuk është përmbushur, dhe kjo duhet të merret parasysh gjatë vlerësimit të ofertës dhe të ketë pasojat përkatëse në pajtim me kërkesat e Dosjes së Tenderit

Shkelja 9 - Për këtë pajisje është paraqitur vetëm një kontratë shitblerjeje në mes të Kushtrim Minsini dhe kompanisë Kushtrimi NM, mirëpo kontrata e tillë, në mungesë të dokumenteve tjera mbështetëse, nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme se personi në fjalë e ka pasur realisht në posedim dhe pronësi pajisjen para se t’ia shiste kompanisë. Në dosjen e tenderit nuk mund të konsiderohet e mjaftueshme një deklaratë apo kontratë private e shitblerjes kur nuk shoqërohet me dokumentacion që e vërteton ekzistencën dhe posedimin real të pajisjes, sidomos kur bëhet fjalë për një pajisje specifike teknike e cila është kërkuar shprehimisht si kapacitet/pajisje në kuadër të ofertës. Në rastin konkret nuk është paraqitur faturë e blerjes së pajisjes nga Kushtrim Minsini, nuk është paraqitur dëshmi e pagesës apo transferit bankar, nuk është paraqitur ndonjë dokument i mëparshëm i blerjes, dokument i furnizimit, dokument i importit, dokument i doganimit, garanci, numër serik, dokument teknik, dëshmi e servisimit apo ndonjë dëshmi tjetër objektive që do të mund të tregonte se kjo pajisje ka ekzistuar, se ka qenë në posedim të personit që pretendohet se e ka shitur dhe se më pas është transferuar te biznesi tejter për më tepër

kontrata është bërë në relacionin babë-djalë dhe në kontratë kanë shtuar paisje edhe që nuk i perkasin gjeneratorit Honda që shërben vetëm për prodhim të energjise sipas kësaj që mund të shihet nga kontrata e gjeneratorit Honda kanë shtuar në kontratë gjëra për nevojë të kriterëve të tendereve për të cilat nuk posedohet asnjë kontratë, faur, dunde apo ndonjë dëshmi tjetër se prej nga është blerë paisja. Për më tepër, vetë kontrata e shitblerjes nuk e zëvendëson automatikisht dëshminë e posedimit real të pajisjes dhe nuk mund të merret si provë e pakontestueshme vetëm për shkak se është paraqitur si dokument. Autoriteti Kontraktues ka pasur detyrim që të vlerësojë në mënyrë reale dhe objektive nëse dokumentacioni i dorëzuar e dëshmon përmbushjen e kërkesës së dosjes së tenderit dhe nëse pajisja e deklaruar ka qenë realisht në dispozicion të operatorit ekonomik. Në vend të një verifikimi të tillë, Autoriteti Kontraktues ka pranuar një dokument të vetëm, pa kërkuar apo vlerësuar dëshmi të tjera që do ta mbështesnin pretendimin për ekzistencën, pronësinë dhe transferimin e pajisjes. Kjo mënyrë e vlerësimit është e parregullt dhe paraqet favorizim të drejtpërdrejtë të operatorit ekonomik të shpallur fitues, sepse Autoriteti Kontraktues ka toleruar një standard të ulët të dëshmimeve për këtë operator, ndërsa kërkesat e dosjes së tenderit duhet të zbatohen njësoj ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë. Në akuzojmë drejtpërdrejt Autoritetin Kontraktues se, duke e pranuar këtë dokumentacion të mangët si të mjaftueshëm dhe duke mos kërkuar verifikim të posedimit real të pajisjes, ka bërë favorizim të operatorit ekonomik të shpallur fitues dhe ka cenuar parimin e trajtimit të barabartë dhe të vlerësimit objektiv të ofertave. Nuk mund të pranohet që një operator ekonomik të konsiderohet se e ka përmbushur kërkesën për një pajisje të caktuar vetëm përmes një kontrate private të shitblerjes, pa asnjë dëshmi tjetër që tregon se pajisja ka qenë realisht në pronësi dhe posedim të shitësit dhe se është transferuar në mënyrë reale te operatori ekonomik. Nëse një dokument i tillë do të konsiderohej i mjaftueshëm, atëherë çdo operator ekonomik do të mund të paraqiste një kontratë të ngjashme vetëm për qëllim të plotësimit formal të kriterit, pa pasur realisht pajisjen në dispozicion. Pikërisht për këtë arsye, Autoriteti Kontraktues ka qenë i obliguar të kontrollojë substancën e dëshmisë dhe jo vetëm ekzistencën formale të një kontrate. Prandaj, kërkojmë që kjo çështje të shqyrtohet në mënyrë të plotë, të kërkohej dëshmi konkrete dhe të verifikueshme për origjinën, pronësinë, posedimin dhe transferimin e pajisjes “Një makinë për saldime të gypave PVC/PE”, si dhe të konstatohet se kontrata e paraqitur, e vetme dhe pa dokumente mbështetëse, nuk është dëshmi e mjaftueshme për të vërtetuar përmbushjen e kërkesës së tenderit. Si rrjedhojë, kërkojmë që oferta e operatorit ekonomik të shpallur fitues të rivlerësohet në mënyrë të ligjshme dhe objektive dhe të mos lejohet që një dokumentacion i tillë i paplotë të përdoret për të krijuar avantazh të padrejtë ndaj operatorëve tjerë. Autoriteti Kontraktues duhet të japë një arsyetim konkret se mbi çfarë baze e ka konsideruar këtë kontratë të mjaftueshme për të dëshmuar posedimin real të pajisjes dhe përse nuk ka kërkuar asnjë dëshmi objektive shtesë. Në mungesë të një arsyetimi të tillë, vlerësimi i bërë duhet të konsiderohet i kundërligjshëm dhe si një veprim që ka favorizuar drejtpërdrejt operatorin ekonomik të shpallur fitues në kundërshtim me parimet e transparencës, barazisë dhe konkurrencës së drejtë në procedurën e prokurimit.

- **Shkelja 10** - Për **Një makine për saldime të gypave PVC PE**, gjithashtu në kontratën e shitblerjes nuk figuron që ekziston paisja sipas kërkesës së dosjes së tenderit, në sqarimet e dhëna të kërkuara nga ana e kompanisë prodhuese, shumë qartas ajo ka shtjelluar që mund të jetë paisja nëse i bëhet edhe shtimi i pjese shtesë i gjithë ky komunikim është ofruar në pyetje dhe përgjigje shtesë.

Shkelja 11 - Në kërkesat teknike të Autoritetit Kontraktues është kërkuar në mënyrë të qartë dhe të specifikuar “Traktor me lugë ngarkuese me lopatë rrafshuese”, pra një pajisje e cila duhet t’i përmbushë këto karakteristika

dhe të jetë në përputhje me përshkrimin teknik të kërkuar. Megjithatë, nga dokumentacioni i dorëzuar nga operatori ekonomik fitues rezulton se pajisja e deklaruar dhe e dokumentuar nuk është ajo që është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues, pasi në dokumentin unik doganor pajisja është e evidentuar si “lopatë ngarkuese (bager)”. Kjo mospërputhje nuk mund të konsiderohet thjesht si ndryshim terminologjik apo formal, pasi dokumenti unik doganor është dokument zyrtar i cili identifikon dhe përshkruan mallin/pajisjen e importuar dhe për këtë arsye përmbajtja e tij duhet të merret seriozisht gjatë verifikimit të përputhshmërisë së ofertës. Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar një kërkesë të caktuar teknike, ndërsa dokumentacioni i operatorit fitues tregon një pajisje me përshkrim tjetër nga ai i kërkuar. Nëse është kërkuar “traktor me lugë ngarkuese me lopata rrafshuese”, atëherë operatori ekonomik duhet të dëshmojë se pajisja e ofertuar është pikërisht e tillë dhe se i përmbush të gjitha karakteristikat teknike të kërkuara në dosjen e tenderit. Nuk mjafton vetëm fakti që pajisja mund të kryejë punë të ngjashme ose të ketë funksion të përafërt me pajisjen e kërkuar, nëse specifikimet dhe dokumentacioni i saj nuk përputhen me kërkesën konkrete të Autoritetit Kontraktues. Në këtë rast ekziston një dallim i rëndësishëm ndërmjet asaj që është kërkuar dhe asaj që është deklaruar/dokumentuar nga operatori ekonomik fitues. Për më tepër, nëse dokumenti unik doganor i pajisjes së paraqitur nga operatori fitues e përshkruan atë si “lopatë ngarkuese (bager)”, atëherë pajisja e ofertuar nuk është pajisja e kërkuar në dokumentet e tenderit. Për këtë arsye, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka pasur obligim që këtë mospërputhje ta verifikojë në mënyrë të plotë dhe objektive, duke krahasuar kërkesën teknike me dokumentet e dorëzuara nga operatori ekonomik fitues dhe duke kërkuar dëshmi të qarta se pajisja e ofertuar realisht i përmbush të gjitha specifikimet e kërkuara. Pranimi i një pajisjeje tjetër nga ajo e kërkuar do të cenonte parimin e trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, sepse operatorët kanë përgatitur ofertat e tyre duke u bazuar në kërkesat konkrete të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues. Nëse një operator lejohet të ofertojë një pajisje e cila nuk përputhet me përshkrimin dhe specifikimet e kërkuara, atëherë krijohet një avantazh i padrejtë ndaj operatorëve të tjerë të cilët kanë respektuar kërkesat e tenderit dhe kanë ofertuar pajisjen sipas specifikimit të kërkuar. Po ashtu, nuk do të ishte e drejtë që një mospërputhje e tillë të trajtohej si një mangësi e parëndësishme, pasi karakteristika dhe lloji i pajisjes janë pjesë e rëndësishme e objektit të prokurimit dhe lidhen drejtpërdrejt me atë se çfarë pajisjeje do të pranojë Autoriteti Kontraktues në përmbushje të kontratës. Për këtë arsye kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të bëjë një rivlerësim të plotë të ofertës së operatorit ekonomik fitues, duke verifikuar dokumentin unik doganor, dhe çdo dokument tjetër të paraqitur në ofertë, siç rezulton nga dokumenti unik doganor dhe kërkojmë që oferta e operatorit ekonomik fitues të trajtohet në përputhje me dispozitat dhe rregullat e aplikueshme të prokurimit publik dhe të mos konsiderohet ofertë e përgjegjshme në raport me kërkesat teknike të tenderit. Gjithashtu, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të na njoftojë në mënyrë të arsyetuar se mbi çfarë baze është konsideruar se pajisja e dokumentuar si “lopatë ngarkuese (bager)” është e barasvlershme dhe përmbush kërkesën konkrete për “Traktor me lugë ngarkuese me lopata rrafshuese”, duke marrë parasysh se këto janë përshkrime të ndryshme të pajisjeve dhe se dokumenti doganor është një dokument zyrtar që duhet të merret parasysh gjatë vlerësimit. Kërkojmë që gjatë rishqyrtimit të mos merret për bazë vetëm deklarimi i operatorit ekonomik, por të shqyrtohen faktet dhe dokumentet objektive të dorëzuara në ofertë, në mënyrë që vendimi përfundimtar të jetë i bazuar në dokumentacion dhe në kërkesat e përcaktuara paraprakisht nga Autoriteti Kontraktues. Në bazë të të gjitha këtyre rrethanave, konsiderojmë se ekzistojnë arsye të mjaftueshme për rishqyrtimin e vendimit dhe për verifikimin e përputhshmërisë së ofertës së operatorit ekonomik të shpallur fitues. Për këtë arsye kërkojmë që kërkesa jonë të shqyrtohet me kujdes, të verifikohet dokumentacioni i pajisjes së ofertuar dhe, nëse konstatohet se ajo nuk përputhet me kërkesën teknike të përcaktuar në tender, të ndërmerren masat përkatëse sipas legjislacionit dhe rregullave të prokurimit publik. Qëllimi i kësaj kërkesë nuk është vetëm kundërshtimi i rezultatit të procedurës, por mbi të gjitha sigurimi që vlerësimi i ofertave të bëhet në mënyrë të barabartë, transparente dhe në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, në mënyrë që të gjithë operatorët ekonomikë të trajtohen me të njëjtat kritere dhe që kontrata të realizohet me pajisjen që realisht është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues.

- **Shkelja 12-** Më datën 07.07.2026, Autoriteti Kontraktues i ka kërkuar Grupit të Operatorëve Ekonomikë **Kom Group SH.P.K.; KUSHTRIMI NM SH.P.K.; Company Murseli SH.P.K.** sqarim lidhur me pajisjen **“Nje makine per saldim te gypave PVC PE”**.

Nga kjo kërkesë është e qartë se Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që operatori ekonomik të dëshmojë në mënyrë konkrete se pajisja e ofruar e përmbush funksionin e kërkuar për PVC/PE. Nëse përgjigjja dhe dëshmia e paraqitur më 07.07.2026 nuk do ta dëshmonte këtë kërkesë, atëherë oferta nuk do të mund të

konsiderohej se e përmbushte kërkesën teknike dhe, rrjedhimisht, do të duhej të eliminohej Mirëpo, nga dokumentet e qasshme rezulton një rrethanë shumë e rëndësishme: Kom Group SH.P.K më saktësisht 21ditë pas kërkesës së Autoritetit Kontraktues më datat 28.07.2026 dhe 03.08.2026 ka zhvilluar komunikime me prodhuesin lidhur pikërisht me konfirmimin e kësaj pajisjeje, ndërsa Autoriteti Kontraktues, më pas, më datën 05.08.2026, ka bërë përsëri kërkesë për informata/sqarime shtesë për të njëjtën pajisje.

Kjo ngre një pyetje thelbësore: ***Nëse Autoriteti Kontraktues e ka bërë kërkesën për sqarim më 07.07.2026, mbi çfarë baze operatori ekonomik ka filluar të kërkojë konfirmim nga prodhuesi vetëm më 28.07.2026 dhe më 03.08.2026?***

Kjo tregon se, në kohën kur Autoriteti Kontraktues kishte kërkuar sqarimin fillestar më 07.07.2026, operatori ekonomik nuk duket se kishte në dispozicion konfirmimin e prodhuesit për funksionin e pajisjes për PVC/PE. Përndryshe, nuk do të kishte pasur nevojë që rreth tri javë më vonë, më 28.07.2026 dhe 03.08.2026, të zhvillonte komunikime me prodhuesin për të siguruar pikërisht këtë dëshmi.

Edhe më shqetësuese është fakti se, pas këtyre komunikimeve të operatorit ekonomik me prodhuesin, Autoriteti Kontraktues më 05.08.2026 ka kërkuar përsëri sqarime/informata shtesë për të njëjtën pajisje.

Pra, kronologjia është: **07.07.2026** – Autoriteti Kontraktues kërkon sqarim për pajisjen;

- **28.07.2026** – Kom Group SH.P.K. komunikon me prodhuesin lidhur me pajisjen;
- **03.08.2026** – zhvillohen përsëri komunikime me prodhuesin për të njëjtën çështje;
- **05.08.2026** – Autoriteti Kontraktues kërkon përsëri informata/sqarime shtesë për pajisjen.

Kjo kronologji krijon dyshimin e arsyeshëm se sqarimi fillestar i datës 07.07.2026 nuk ka qenë i mjaftueshëm për të dëshmuar përmbushjen e kërkesës teknike, dhe se operatorit ekonomik i është dhënë mundësi që, përmes komunikimeve të mëvonshme me prodhuesin, të sigurojë dokumentacion shtesë për ta mbështetur një kërkesë që duhej të ishte dëshmuar në mënyrë të qartë që në fazën përkatëse të sqarimit.

Nëse dokumentacioni i siguruar më 28.07.2026 dhe 03.08.2026 është përdorur për të plotësuar pikërisht mungesën e dëshmisë që nuk ishte paraqitur në përgjigjen e datës 07.07.2026, atëherë nuk kemi të bëjmë më me një sqarim të thjeshtë të një informacioni ekzistues, por me sigurimin e një dëshmie të re pas kërkesës fillestare për sqarim.

Për këtë arsye, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të shqyrtojë në mënyrë të detajuar kronologjinë e dokumenteve dhe komunikimeve, dhe të konstatojë nëse dokumentacioni i datave 28.07.2026 dhe 03.08.2026 është përdorur për të plotësuar një mangësi që ekzistonte që në përgjigjen e parë të datës 07.07.2026. Nëse kjo konfirmohet, atëherë pranimi i këtyre dokumenteve të mëvonshme do të përbënte trajtim të pabarabartë të ofertuesve dhe do t'i mundësonte operatorit ekonomik të plotësojë një kërkesë pas afatit përkatës, ndërkohë që në rast se sqarimi i datës 07.07.2026 nuk e përmbushte kërkesën, oferta duhej të konsiderohej e papranueshme dhe të eliminohej nga procedura.

Shkelja 13

Në dokumentacionin e dorëzuar nga grupi i operatorëve ekonomikë **Kom Group SH.P.K.; KUSHTRIMI NM SH.P.K.; dhe Company Murseli SH.P.K.** është konstatuar një mangësi thelbësore në dokumentin e marrëveshjes/deklaratës për formimin e grupit të operatorëve ekonomikë, pasi në këtë dokument nuk është përcaktuar personi i autorizuar për përfaqësimin e grupit dhe, rrjedhimisht, nuk rezulton nënshkrimi i deklaratës nga personi i autorizuar në këtë

cilësi, ashtu siç parashihet në formularin zyrtar të publikuar nga KRPP. Kjo mangësi nuk mund të trajtohet si një gabim i parëndësishëm estetik, teknik apo formal, pasi lidhet drejtpërdrejt me identifikimin e personit që ka të drejtë të përfaqësojë grupin e operatorëve ekonomikë dhe me autorizimin për të vepruar në emër të tij gjatë procedurës së prokurimit. Pikërisht për këtë arsye, KRPP ka publikuar dokumentin standard **“MARRËVESHJE DEKLARATE për formimin e grupit 2024”**, të publikuar më **11.11.2024** në platformën zyrtare të prokurimit elektronik, i cili përcakton elementet që duhet të përmbajë marrëveshja/deklarata e grupit. Autoriteti Kontraktues nuk mund të sillet sikur ky dokument standard nuk ekziston, veçanërisht kur bëhet fjalë për një formular të publikuar nga vetë KRPP dhe të destinuar për përdorim në procedurat e prokurimit publik. Për këtë arsye, pyetja themelore që kërkojmë t'i përgjigjet Autoriteti Kontraktues është: **Nëse formulari zyrtar i KRPP-së kërkon përcaktimin dhe nënshkrimin nga personi i autorizuar për përfaqësimin e grupit, mbi çfarë baze ligjore dhe mbi çfarë arsyetimi profesional është pranuar një deklaratë e cila nuk e përmban këtë element?** Nëse Autoriteti Kontraktues konsideron se mungesa e përcaktimit të personit të autorizuar dhe e nënshkrimit të tij nuk ndikon në vlefshmërinë e deklaratës, atëherë duhet të identifikojë qartë dispozitën konkrete ligjore, nenin përkatës të Dosjes së Tenderit, dispozitën apo kërkesën përkatëse të dokumentit standard të KRPP-së, si dhe arsyetimin konkret se përse kjo mangësi është konsideruar e pranueshme. Në të njëjtën kohë, duhet të shpjegohet se mbi çfarë baze do të trajtohej një operator tjetër ekonomik në rrethana identike. Nuk mund të ekzistojë një standard i ndryshëm vlerësimi për operatorë ekonomikë të ndryshëm, ku një kërkesë dokumentare konsiderohet e detyrueshme për një operator, ndërsa për një operator tjetër konsiderohet e parëndësishme pa ekzistuar një bazë objektive dhe ligjore për këtë dallim. Një qasje e tillë do të cenonte parimet themelore të trajtimit të barabartë, transparencës dhe konkurrencës së ndershme në prokurimin publik. Kur një grup operatorësh ekonomikë paraqitet në procedurë si një grup i përbashkët, Autoriteti Kontraktues duhet të ketë të qartë se kush e përfaqëson grupin, në çfarë cilësie vepron ai person dhe mbi çfarë autorizimi ka të drejtë të ndërmarrë veprime në emër të grupit. Kjo është veçanërisht e rëndësishme duke pasur parasysh se legjislacioni për prokurimin publik njihë pjesëmarrjen e grupeve të operatorëve ekonomikë dhe përcakton përgjegjësinë e tyre në lidhje me tenderin dhe, në rast të dhënies së kontratës, edhe me ekzekutimin e saj. Për këtë arsye, mënyra e përfaqësimit të grupit dhe autorizimi i personit që vepron në emër të tij nuk mund të reduktohen në një çështje të parëndësishme procedurale. I referohemi drejtpërdrejt dokumentit zyrtar të KRPP-së **“MARRËVESHJE DEKLARATE për formimin e grupit 2024”**, me datë publikimi **11.11.2024**, dhe kërkojmë që gjatë rishqyrtimit të bëhet një krahasim i drejtpërdrejtë ndërmjet këtij formulari standard dhe dokumentit të dorëzuar nga grupi **Kom Group SH.P.K.; KUSHTRIMI NM SH.P.K.; dhe Company Murseli SH.P.K.** Nga ky krahasim duhet të konstatohet në mënyrë objektive nëse dokumenti i dorëzuar përmban të gjitha elementet e kërkuara dhe, në veçanti, nëse është përcaktuar personi i autorizuar për përfaqësimin e grupit dhe nëse deklarata është nënshkruar nga ai person në cilësinë përkatëse. Nëse këto elemente mungojnë, Autoriteti Kontraktues duhet të japë një shpjegim të qartë se mbi çfarë dispozite ligjore, kërkesë të Dosjes së Tenderit ose interpretimi të dokumentit standard të KRPP-së është konsideruar dokumenti i vlefshëm dhe i pranueshëm. Gjithashtu, kërkojmë të sqarohet nëse Autoriteti Kontraktues e ka verifikuar dhe krahasuar dokumentin standard të KRPP-së me dokumentin konkret të dorëzuar nga grupi i operatorëve ekonomikë dhe, nëse po, cilat kanë qenë arsyet që kanë çuar në përfundimin se mungesa e këtyre elementeve nuk ndikon në vlefshmërinë e dokumentit. Kërkesa jonë nuk ka për qëllim ta detyrojë Autoritetin Kontraktues

të marrë një vendim në favor të ndonjë operatori ekonomik, por kërkon vetëm zbatimin e të njëjtit standard ndaj të gjithë pjesëmarrësve në procedurë. Nëse personi i autorizuar kërkohet, ai duhet të identifikohet; nëse nënshkrimi i tij kërkohet, ai duhet të ekzistojë; ndërsa nëse Autoriteti konsideron se këto elemente nuk janë të domosdoshme, duhet të tregojë qartë bazën ligjore dhe dokumentare që e mbështet këtë përfundim. Ajo që nuk mund të pranohet është që një kërkesë e përcaktuar në dokumentacionin zyrtar të procedurës dhe në formularin standard të KRPP-së të zbatohet në mënyrë selektive ose të shpërfillet vetëm në rastin e një operatori ekonomik. Nëse kjo mangësi është konstatuar vetëm pas shpalljes së rezultatit ose pasi është ngritur si çështje nga operatori kundërshtues, nuk mund të lejohet që dokumenti të plotësohet ose të korrigjohet në mënyrë retroaktive për të arsyetuar pranimin e ofertës, nëse një veprim i tillë do të nënkuptonte ndryshim të gjendjes së ofertës pas afatit të dorëzimit dhe do të cenonte parimet e barazisë së operatorëve ekonomikë. Komisioni vlerësues ka detyrim të kontrollojë nëse dokumentacioni i dorëzuar përmbush kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe në kuadrin përkatës ligjor, ndërsa Autoriteti Kontraktues mban përgjegjësi për ligjshmërinë dhe integritetin e procedurës. Për këtë arsye, nuk mjafton që Autoriteti të deklarojë në mënyrë të përgjithshme se mangësia është “formale” ose “e parëndësishme”; duhet të identifikohet baza konkrete ligjore dhe dokumentare mbi të cilën mbështetet një përfundim i tillë. Nëse Autoriteti Kontraktues e mban në fuqi vendimin pa dhënë një arsyetim të qartë, konkret dhe të verifikueshëm për pranimin e dokumentit të kontestuar, atëherë mbetet një çështje serioze në lidhje me respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë dhe transparencës në procedurën e prokurimit. Për rrjedhojë, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues, gjatë rishqyrtimit, të analizojë në mënyrë të plotë dhe objektive dokumentin e dorëzuar nga grupi **Kom Group SH.P.K.; KUSHTRIMI NM SH.P.K.; dhe Company Murseli SH.P.K.**, ta krahasojë atë me formularin standard të KRPP-së të datës 11.11.2024, të përcaktojë nëse është identifikuar dhe autorizuar personi që përfaqëson grupin dhe nëse deklarata është nënshkruar në përputhje me kërkesat përkatëse, si dhe të japë arsyetim të plotë dhe të bazuar në ligj në rast se konstaton se mungesa e këtyre elementeve nuk përbën pengesë për pranueshmërinë e ofertës. Çdo vendim duhet të bazohet në të njëjtin standard ligjor dhe procedural që zbatohet ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë, pasi vetëm një qasje e tillë garanton ligjshmërinë, transparencën, integritetin dhe besueshmërinë e procedurës së prokurimit publik.

Autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Gjithashtu Autoriteti kontraktues nuk ka vepruar në harmoni me nenin 6 të LPP-së, ku autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së. Shihet qartë se AK ka bere shkelje te nenit 7 te LPP-së ku ne piken 1 thuhet se : Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Ndërsa në piken 2 thuhet :Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.

Besojmë se i kemi elaboruar me shume se sa qe duhet shkeljet e AK-se ne këtë aktivitet te Prokurimit andaj kërkojmë nga ana juaj si Organ Shqyrtues i prokurimit që të nxjerret:

V E N D I M

APROVOHET si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e Operatorit Ekonomik : Komplast 1985 SHPK

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES** ne lidhje me aktivitetin e prokurimit: **Mirmbajtja e sistemit të ujitjes dhe ujitja e sipërfaqeve gjelbëruese** me nr. te prokurimit: **616-26-2559-2-1-1**dhe lënda te kthehet.

RIVLERËSIM dhe pas rivlerësimit te shpallemi fitues i këtij aktiviteti te prokurimit, në të kundërtën jemi të obliguar që të parashtrojmë Ankesë konform ligjit brenda afateve ligjore.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shpenzimet mbi angazhimin ne përgatitjen e ofertave, sigurimin e ofertës, shpenzimet administrative dhe fitimin.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) *një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë”*
- b) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve*
- c) *Njoftimi mbi vendimin e AK.*